

## Shoqerite Sekrete dhe Rendi i Ri Boteror

Historia eshte e mbushur me peshperitje mbi shoqerite secrete. Kronika te trashegimtareve ose prifterinjve te cilet kane ruajtur me fanatizem njohurine e ndaluar te njerezve te lashte. Njerez te rendesishem te cilet mblidheshin ne fshehtesi te plote te cilet kane drejtuar rroten e civilizimit, jane te rregjistruar neper shkrimet e te gjitha popujve.

Me e vjetra eshte Vellazeria e Gjarperit e quajtur ndryshe edhe si Vellazeria e Dragoit qe vazhdon te ekzistojte edhe sot e kesaj dite nen emra te ndryshem. Eshte e qarte qe feja ka luajtur nje rrol kryesor ne rrjedhen e ketyre organizatave. Komunikimi me nje burim me te larte, shpesh hyjnor, eshte nje deklarate e zakonshme per ata.

Sekretet e ketyre grupeve thuhet se jane kaq te thella dhe te fshehura sa vetem nje pjese e mire arsimuar dhe e zgjedhur jane ne gjendje ti kuptojne dhe ti perdorin. Keta njerez i perdorin njohurite e tyre per te miren e njerezimit. Te pakten kjo eshte ajo qe ata deklarojne. Si mund ta dime ne kete gje kur njohurite dhe veprimet e tyre kane qene secrete? Per fat te mire disa prej tyre tashme jane shnderruar ne njohuri publike.

E konsideroj si shume intriguese qe shume, ne mos ne te gjitha shoqerite tribale primitive te gjitha adultet jane pjestare. Zakonisht ata jane te ndare ne grupe meshkujsh dhe grupe femrash. Zakonisht eshte mashkulli ai qe dominon kulturen. Ne menyre surprize kjo ngjan ne menyre te perpikte me disa nga shoqerite secrete te civilizuar. Dhe kjo do te thote vetem qe shoqeria nuk punon kunder autoritetit te vendosur por per te. Ne fakt mund te thuhet per autoritetin aktual te stabilizuar. Kjo ka tendencen te rrezojte poshte pretendimin dhe vleren e cdo argumenti qe shoqerite secrete jane te dedikuara ndaj "shkaterrimit te autoritetit kushtetues". Dhe kjo mund te aplikohet natyrisht atehere kur shoqerite secrete perbejne pjesen me te madhe te gjitha popullates qe preket nga ky aksion. Vetem nje grup i vogel ben pjese ne kete kategori.

Shoqerite secrete ne fakt pasqyrojne shume nga aspektet e zakonshme te jetes. Ka gjithmone nje ekskluzivitet ne anetaresi qe ka si rezultante rendesine e bashkangjitur te te qenurit ose berit anetar. Kjo gje eshte hasur gjate gjitha orvatjeve te njerezimit, madje edhe ato qe nuk jane secrete si psh skuadrat e futbollit ose klubet e te pasurve. Ky ekskluzivitet anetaresie eshte aktualisht nje nga armet me te fuqishme te shoqerive secrete. Ato perdorin shenja, fjalekalime dhe mjete te tjera. Keto gjera kane krijuar gjithmone funksione te vlefshme ne organizatat kudo qe ndodhen. Arsyeya e deklaruar, pothuajse gjithmone e ndryshme nga arsyeya e vertete perben rendesine e ekzistences se vete shoqerise.

Sidomos miqesia eshte e nje rendesie te vecante. Te ndash vuajtjen dhe sekretin ka qene gjithmone nje trill special per njeriun. Sidomos ata qe kane kaluar eksperiencat neper kampet e stervitjes se veshtire nuk kane per ta harruar kurre rendesine dhe ndjesine speciale i perkatesise dhe miqesise qe ndahet midis viktimave te tekave te rreshtereve dhe komandanteve te skuadrave. Eshte nje emocion qe lind nga nisja ose fillimi. Mjeti me i

fuqishem i cdo shoqerie sekrete eshte rituali dhe miti qe e rrethon fillimin. Keto ceremoni te detyrueshme kane nje kuptim thellesisht te vecante per pjestaret.

Nisja permban disa funksione te cilat perbejne zemren dhe shpirtin e nje shoqerie sekrete te vertete. Ashtu si dhe kampi i stervitjes se veshtire, nisja ose fillimi ne ushtri, jane aspekte te rendesishme te mendimit njerezor qe shkrihen ne menyre universale dhe qe sherbejne per trajnimin dhe mirembajne perpjekjet e nje grupi njerezish qe operojne ne nje drejtim te caktuar. Nisja i lidh te gjitha pjestaret ne misticizem.

Neofitet fitojne njohuri per nje sekret duke ju thene atyre nje status special. Kuptimi i lashte per neofite eshte "i mbjelle perseri ose i rilindur." Nje nisje me e larte eshte ne realitet nje ngritje ne pozite qe frymazon besnikeri dhe deshire per te shkuar me lart, ne rangun tjetere. Qellimet e shoqerive jane perforecuar duke bere qe i nisuri te reagoje ndaj ketyre qellimeve ne cdo moment te jetes se zakonshme. Kjo sjell nje ndryshim ne veprimet shoqerore dhe politike te nje anetari. Ndryshimi eshte gjithmone ne interes te qellimeve te lidereve te shoqerive sekrete. Lideret quhen adepts. Kjo mund te krahasohet duke dhene si shembull ushtarin qe eshte trajnuar ti bindet urdherave pa menduar. Rezultati eshte shpesh plagosja ose vdekja e ushtarit per te realizuar qellimin e komandantit qe mund te jete ose mund te mos i jete i mire per gjitha komunitetin.

Nisja eshte nje menyre per te shperblyer njerez ambicioze te cileve mund tju besohet. Mund te vini re qe sa me lart te shkoje niveli i nisjes, aq me i pakot eshte numri i anetareve qe kane ate nivel. Kjo nuk ndodh sepse anetaret e tjere nuk jane ambicioz por sepse behet nje proces selektimi shume i kujdesshem. Arrihet nje pike ku asnje perpjekje nuk mjafton me dhe ne kete moment duhet nje shtyrje nga ndonje anetar i kupoles. Shume anetare nuk e kalojne asnjehere kete pike dhe nuk e mesojne kurre te verteten dhe arsyen reale te grupit. Qe nga ky moment, anetari i "ngrire" sherben vetem si pjese e bazes se fuqise politike. Pra ne kete pike besoj se ju keni arritur te kuptoni se Nisja eshte nje proces per te determinuar se kujt mund dhe kujt smund ti besohet.

Nje menyre per te percaktuar me saktesi se kush do behet nje adept eshte kur gjate Nisjes i kerkohet kandidatit qe te peshtyje mbi kryqiin kristian. Nese kandidati refuzon, atehere anetaret e pershendesin ate dhe i thone, "Ju moret vendimin e duhur pasi asnje adept i vertete nuk do te mund te bente nje gje kaq te temerrshme." Me pas i Nisuri i ri mund te jete i pakenaqur nga fakti qe ai nuk po avancon me lart ne oligarki. Por nese kandidati peshtyn mbi kryq atehere ai ose ajo demonstroi qe ka njohuri per nje nga misteret dhe shume shpejt do e shikoje veten si nje kandidat per nje nivel me lart. Misteri eshte qe feja eshte vetem nje mjet per te kontrolluar masat. Dituria [ose urtesia] eshte zoti i vetem nepermjet te cilit vete njeriu mund te behet zot. Gjarperi dhe Dragoi jane te dy bashke simbole te Urtesise. Luciferi eshte personifikimi i simbolit. Ishte Luciferi ai qe shtuy Even te joshte Adamin qe te hante nga pema e diturise duke u shnderruar keshtu ne nje njeri te lire dhe i cliruar nga injoranca. ADHURIMI [shume i ndryshem nga STUDIMI] i diturise, shkencave ose teknologjise eshte Satanizmi ne formen e tij me te paster dhe simboli i tij sekret eshte Syri qe Sheh Cdo Gje ne maje te piramides.

Efektet e padeshirueshme te shoqerive sekrete si dhe aureola e misterit qe i shoqeron, shpesh i ka dhene atyre reputacionin e te qenurit nje shoqeri abnormale, madje edhe

klasifikime si grup i cuditshem njerezish. Ne momentin qe besimi i tyre perben ate te shumices atehere ata nuk konsiderohen me si antisociale. Nje shembull i sakte eshte ai i kishesh kristiane e cila vete njehere e nje kohe ka qene nje shoqeri sekrete nen Perandorine Romake. Ne fakt Shoqeria Sekrete Miqesore e Hapur [Vatikani] ka sunduar pjesen me te madhe, ne mos gjithë boten e njohur te asaj kohe.

Shume nga shoqerite sekrete ne pergjithesi konsiderohen te jene antisociale, ato besohet se permbajne elemente qe nuk pelqehen ose qe jane te demshme per komunitetin ne pergjithesi. Dhe ne fakt ky eshte rasti ne shumicen e fakteve. Komunizmi dhe Fashizmi ne shume vende te botes jane shoqeri sekrete dhe ndalohen me ligj. Ne Amerike partia Naziste dhe Ku Klux Klan ajne shoqeri sekrete per shkak te faktin qe publiku i pergjithshem ka mospelqim te madh ndaj tyre. Aktivitetet e tyre ndonjehere jane ilegale dhe si rrjedhoje edhe vete anetaresia eshte sekrete. Kristianet e hershem ishin nje shoqeri sekrete sepse autoritetet e Romes i konsideronin ato qe nga fillimi si te rrezikshme per sundimin perandorak. E njejta gje ishte e vertete edhe per pasuesit e Islamit. Drused dhe Yezidis ne Siri dhe Irak i konsideronin Arabet nje shoqeri sekrete e rrezikshme e dedikuar per te marre kontrollin e gjithë botes. Sot, Arabet mendojne te njejten gje per Cifutet. Katoliket dhe Freemasonet kane patur te njejtat ide per njeri tjetrin.

Qe nga fillimi i historise se rregjistruar, leva te cdo qeverie jane perfshire ne perpjekje per te mbajtur nje statu quo qe do te mbronte qeverisjen nga grupet e minoriteteve te cilat duan te veprojne si shtet brenda shtetit ose te nxjerrin jashte loje autoritetin kushtetues dhe te zene vendin e tij.

Shume nga keto perpjekje kane dale mbane por jo gjithmone kane zgjatur. Dëshira njerezore per tu bere nje nga te zgjedhurit eshte njera nga ato qe asnje nga fuqite ne kete bote ja ka dale ta mundi. Eshte nje nga “sekretet” e shoqerive sekrete. Eshte ajo qe i jep atyre nje baze politike dhe shume pushtet. Anetaret shpesh votojne te njejtin person dhe i japin njeri tjetrit preferencat e tyre ne bizneset e perditshme, aktivitetet legale dhe ato sociale. Eshte deshira me e thelle e te gjithëve ajo qe te thone “Bej pjese tek te zgjedhurit.”

Ne qytetet e lashta kane ekzistuar shtepi per sakrifica dhe falje. Ato kane qene ne fakt tempuj te ndertuara per nder te shume perendive. Keto ndertesa shpesh kane funksionuar si vende takimi per filozofet dhe mistiket te cilet besonin se zoteronin sekretet e natyres. Keta njerez diskutonin me njeri tjetrin per ndasite filozofike dhe ato te shkollave fetare.

Me i rendesishmi nga keto grupe te lashte eshte Vellazeria e Gjarperit ose e Dragoit dhe njihej thjesht me emrin Misteret. Gjarperi dhe Dragoi jane simbole qe perfaqesojne urtesine. Babai i urtesise eshte Luciferi i quajtur ndryshe edhe si Mbartesi i Drites. Fokusimi i adhurimit per Misteret ishte Osiris, emri i nje ylli te shndritshem per te cilin antiket besonin se kishte ardhur ne Toke. Kuptimi i sakte per Luciferin eshte ‘pruresi i drites’ ose ‘ylli i mengjesit’. Kur Osiris u largua nga qielli, antiket pane diellin si perfaqesues te Osirisit. [...eshte deklaruar se kur Luciferi ra nga Qiejte, ai solli fuqine e mendimit si nje dhurate per njerezimin.]

Shume nga mendjendriturit me te medhenj qe kane jetuar ne kete planet kane qene te Nisur ne shoqerine e Mistereve nga rite sekrete dhe te rrezikshme disa prej te cilave jane shume mizore. Disa nga me te famshmit qe njihen kane qene Osiris, Isis, Sabazius, Cybele dhe Eleusis. Platoni ishte njeri nga te Nisurit dhe pershkruan disa nga misteret ne shkrimet e tij.

Nisja e Platonit kerkoi qe ai te varrosej per tre dite ne Piramiden e Madhe, kohe gjate te ciles ai vdiq [ne menyre simbolike] dhe me pas rilindi dhe ju dhane sekretet qe ai duhet te ruante. Shkrimet e Platonit jane plot te dhena per Misteret. Ne librin e tij Mesimet Sekrete te te Gjithe Koherave, Manly P. Hall shkruan se; "...te ndricuarit e lashtesise...hyne ne portat e Piramides se Gizes si njerez dhe dolen qe andej si perendi." Fjala e lashte egjyptiane per piramidat ishte khuti qe do te thote "drite e lavdishme". Zoti Hall shprehet per piramidat si Tempujt madheshtore egjyptian te Nisjes...

Sipas disave, piramidat e medha jane ndertuar per te perkujtuar dhe observuar nje shperthim te nje supernova qe ndodhi ne vitin 4000 p.e.s. Dr Anthony Hewish, fitues i cmimit Nobel ne vitin 1974 ne fizike, zbuloi nje sere pulsimesh radioje qe ishin ritmike dhe qe u provuan se leshoheshin nga ylli qe shpertheu ne vitin 4000 p.e.s. Freemasonet e fillojne kalendarin e tyre nga A.L. "Ne Vitin e Drites" qe gjehet kur i shtohen 4000 vitit modern. Pra 1990 (koha kur eshte shkruar ky material) + 4000 = 5990 A.L. Po ashtu kete informacion e gjejme tek shkrimet kuneiform te Sumeraneve ne te cilet pershkruhet; "nje shperthim gjigand i nje ylli ne forme trekendeshe i formuar nga Zeta Puppis, Gamma Velorum dhe Lambada Velorum... vendndodhur ne qiellin jugor... nje katalog i sakte tani deklaroi se ylli shndritshem qe shpertheu brenda trekendeshtit, do shikohet perseri nga njeriu brenda 6000 vjeteve." Sipas kalendarit Freemason do te ndodhi pak mbas vitit 2000 dhe me te vertete do te ndodhe.

Anija kozmike e quajtur Galileo qe eshte duke ju afruar Jupiterit, nje yll i vogel me nje perberje gazesh te ngjashme me diellin tone, ka nje ngarkese prej 49.7 paund me plutonium qe supozohet se perdoret si bateri per te furnizuar anijen. Kur te perfundoje orbiten e tij finale ne dhjetor 1999, Galileo do leshoje ngarkesen e tij ne qender te Jupiterit. Presioni i pabesueshem qe do prodhohet, do shkaktoje nje reaksion te njejte me ate qe ndodh kur nje bombe atomike shperthehet nepermjet nje ndezesi te brendeshem. Plutoniumi do shpertheje ne nje reaksion atomik duke ndezur atmosferen prej hidrogjeni dhe heliumi te Jupiterit qe do rezultojne ne lindjen e nje ylli i cili po ashtu i eshte vene emri qe me pare, Luciferi. Bota do ta interpretojte si nje shenje te temerrshme fetare. Do permbushi profecine.

Ne te vertete eshte vetem nje demonstrim i aplikimit te cmendur te teknologjise nga Shoqeria Jason, gje qe mund edhe te mos funksionojte. Ata kane kryer prova te shumta per te garantuar suksesin por sidoqofte duke ju referuar dokumentave qe kam lexuar kur kam qene ne Inteligjencen e Marines, deklarohet se Projekti Galileo kerkon vetem 5 paund plutonium per te 'ndezur' Jupiterin dhe per te filluar epoken e akullit. Ngrohja globale eshte nje mashtrim. Eshte me e lehte per publikun qe te merret me te dhe ti japi me shume kohe elites sunduese perpara se paniku dhe anarkia te zevendesojte qeverine.

Por ne realitet temperaturat globale po behen gjithmone e me te ulta. Stuhite po behen me te fuqishme dhe me pak te parashikueshme. Majat e akullnajave neper Pole po zmadhohen. Zonat me klime te bute ku mund te mbillen dritherat po zvogelohen gjithmone e me shume. Hapesirat e shkretetirave jane duke u zgjeruar ne zonat tropikale. Nje epoke e re akullnajash eshte duke u afruar dhe do ndodhe krejt pa pritur. Ne menyre simultane do hapet nje qemer ne Egjypt ku ndodhen shkrime antike mbi token. Hapja e qepenit do ndodhi ne mijevjecarin e ri. (Skam lajme te sakta per kete gje por di nje fakt qe celebrimet per mijevjecarin e ri ishin vendosur te beshin ne Egjypt ku do merrnin pjese gjithe personalitetet boterore. Cuditerisht fare pak perpara konfirmimit te plote, evenimenti u anulua. Pati zera qe ndodhi per shkak te zbulimit te dickaje ne afersi te piramidave, ku ishte dhe vendi ne te cilin do kryhej festa. –Darius). Nje feste madheshtore eshte planifikuar te zhvillohet nga Shoqeria e Mijevjecarit tek Piramidat e Egjyptit. Sipas numrit te 3 janarit te vitit 1989 te Arizona Daily Star “Presidenti i Amerikes, Bush po i kalon pushimet e vitit te ri ne Camp David, Maryland por mbas 10 vjetesh ai mund te jete ne Egjypt. Organizatoret e Shoqerise Millenium jane duke punuar per promovimin e festimeve te Mijevjecarit te Ri tek Piramida e Madhe e Keopsit ne Giza.”

Sekreti i pare qe dikush duhet te dije qe te filloje te kuptoje Misteret eshte qe anetaret e tyre besojne se ka vetem fare pak mendje te ndritura ne kete glob. Ata besojne se keto mendje i perkasin ekskluzivisht atyre. Filozofia qe pason eshte kendveshtrimi klasik i shoqerive sekrete ndaj njerezimit.

Kur nje person me intelekt te forte konfrontohet me nje problem qe kerkon perdorimin e arsyes, ai i qendron besnik pozicionit te tij dhe perpiqet te gjeje nje zgjidhje duke mbledhur prova qe i japin pergjigje pyetjeve qe shtrohen. Nga ana tjeter ata qe jane te papjekur, kur perballen me ndonje problem te vogel dorezohen menjehere. Pra ne rastin e pare personi mund te jete i kualifikuar te zgjidhi misterin e vete fatit te tij ndersa i dyti mund te terhiqet prej hunde si nje kafshe dhe ti mesohet gjuha me e thjeshte. Ashtu si bagetite ata jane komplet te varur nga bariu. Me pak fjale intelektit te spikatur i mesohen Misteret dhe e verteta spirituale ezoterike. Ndersa masave ju mesohet interpretimi ezoterik i drejtperdrejte. Ndersa masat i falen 5 shqisave, ata pak te zgjedhur observojne dhe dallojne ne gjirin midis tyre simboliken e ngurte te te vertetes se madhe abstrakte.

I Nisuri i zgjedhur komunikon direkt me Zotat [Alienet?] te cilet ju pergjigjen mbrapsht. Masat sakrifikojne bagetite e tyre neper altare idhujsh te gurte qe as degjojne dhe as flasin. Te zgjedhurve ju jepet dituria e Mistereve dhe ndricohen, ja pse ata quhen Illuminati, ruajtesit e “Sekreteve te Koherave”.

Tre shoqeri sekrete te koherave te hershme qe mund te lidhen direkt me pasardher modern jane Kulti i Roshaniya, Mithras dhe e kunderta e tyre Ndertuesit. Ata kane shume gjera te perbashketa me Freemasonet e sotem si dhe me disa krahe te ndryshem te Illuminatit. Ne rastin konkret, te perbashketa per Vellazerine [ne kohet moderne nuk quhet me e tille por thjesht Organizate] pra per Organizaten jane; rilindja simbolike ne nje jete te re duke kaluar me pare neper porten e vdekjes gjate Nisjes; termi Luani dhe Shtrengimi i Putres se Luanit ne shkallet e Master Mason, tre shkallet e te cilit jane te

njejta me ritet e lashta masonike, perpara se te shtoheshin shkallet e mevonshme; shkalla e shtate shkallezimeve dhe se fundit Syri qe Sheh Cdo Gje.

E nje interesi te vecante eshte nje shoqeri e fuqishme e koheve te lashta ne Afganistan e quajtur Roshaniya – te ndricuarit. Ka referenca aktuale per kete kult mistik qe shkojne mbrapa ne kohe deri tek Shtepia e Urtesise ne Kairo. Parimet kryesore te ketij kulti ishin; zhdukja e prones private, eleminimi i fese, eleminimi i shteteve si kombe, besimi se ndricimi u shpernda nga Qenia Supreme e cila deshironte nje klase perfekte burrash e grash per te marre ne dore drejtimin dhe organizimin e botes, besimi ne nje plan per te riformuar strukuren shoqerore te botes duke marre fillimisht kontrollin mbi vende individuale nje e nga nje dhe besimi qe mbasi te arrihet shkalla e katert mund te komunikohet direkt me Mbikqyresin e Panjohur i cili shperndare njohuri tek te Nisurit gjate koherave. Dhe keshtu te Urtet do e pranojne edhe njehere Organizaten.

Nje fakt i rendesishem qe duhet te kujtojmë eshte qe lideret, qofshin te majte apo te djathte, jane nje grup i vogel, nje berthame e ngjeshur njerezish te cilet kane qene dhe vazhdojne te jene Illuminista ose pjestare te Organizates. Ata mund te kene qene ose mund te jene anetare te besimeve fetare kristiane ose cifute por kjo vlen vetem per te mbuluar qellimet e tyre te verteta. Ata i ofrojne besnikeri cdo vendi ndonese e kane perdorur nacionalizmin si arme per te arritur qellimet e tyre. I vetmi preokupim qe ata kane eshte fitimi nje fuqie me te madhe ekonomike dhe politike. Ndersa qellimi perfundimtar i te gjithe grupeve eshte identik. Ata jane te vendosur per ti dhene vetvetes nje kontroll te padiskutuar monetar, burime natyrore si dhe fuqi politike ne te gjithe planetin. Ata kane per qellim te kthejne boten ne nje koncept te tyren te shtetit totalitar socialist. Gjate ketij procesi ata do eliminojne Kristianet, Cifutet dhe Ateistet. Ju sapo mesuat nje, por vetem nje nga Misteret.

Roshaniya e quan veten e saj dhe Urdheri. Te Nisurit kryejne nje betim qe i cliron ata nga detyrimi i cdo besnikerie pervec asaj ndaj Urdherit. Ja si eshte ky betim; “E detyroj veten time me nje heshtje te plote dhe besnikeri te patundshme ndaj Urdherit...I gjithe njerezimi qe nuk mund te identifikojë veten e tij me shenjat tona sekrete, eshte preja jone e ligjshme.” Betimi ne esence vazhdon te mbetet i njejte edhe sot e kesaj dite. Shenja sekrete ishte prekja e ballit me kurrzin e dores nga jashte ndersa kunderpergjigja ishte te kapje veshin me gishta dhe te mbeshtesje berrylin tek dora tjeter e bere grusht. A ju tingellon familjare kjo shenje? Urdheri eshte Urdheri i Kalvarit. Kultu predikonte qenien e nje gjendje shpirtore ndryshe nga forma jetesore qe njohim ne. Shpirti mund te vazhdonte te ishte i fuqishem ne toke nepermjet pranise se tij tek njeri prej anetareve te Urdherit por vetem nese vete shpirti kishte qene nje anetar i Urdherit perpara vdekjes. Ne kete menyre anetaret e Urdherit moren fuqi nga shpirtirat e anetareve te vdekur.

Roshaniya mori ne gjirin e saj udhetare si te Nisur dhe i dergoi ata qe te gjeni kapituj te tjere te Urdherit. Mendohet se Assassins (Vrasesit) ishin nje krah i Roshaniya. Degezime te Roshaniya ose “te te ndricuareve” ose te Illuminatit ekzistonin dhe vazhdojne te ekzistojne kudo. Njera nga rregullat ishte mosperdorimi i te njejtit emer dhe sidomos shmangia e te permendurit te ILLUMINATI. Ky rregull eshte ne fuqi edhe sot. Mendoj se eshte thyerja e ketij rregulli ajo qe coi ne rrezimin e Adam Weishaupt.

Njeri nga sekretet me te medhenj te te gjithë koherave eshte historia e vertete e Grailit te Shenjte, manteli i Jezusit, mbeturinat e Kryqit te Kryqezimit dhe fakti nese Jezusi aktualisht vdiq apo mbijetoi dhe solli ne jete edhe nje femije. Shume mite qe rrethojne Kalorsit e Tempullit [Knights Templar] ne lidhje me kete relik si dhe shume mite te tjera qe na vijne nga historia kane te pakten disa elemente te bazuara ne fakte reale. Nese burimet e mija te informacionit jane te sakta, Kaloresit e Tempullit kane mbijetuar sot e kesaj dite si nje degezim i Illuminatit dhe ruajne keto relike te cilat mbahen ne nje vend te te ditur vetem prej tyre.

Ne dime se Templaret jane Illuminati sepse Freemasonet absorbuan dhe mbrojten ata qe i shpetuan persekutimit te kishes ne France, ashtu sic Freemasonet do mbronin Adam Weishaupt shekuj me mbrapa. Knights Templar ekzistojne sot e kesaj dite si nje shkalle e larte e Freemasonerise perbrenda Urdherit te Tempullit. Ne fakt vetem Knights Templar eshte nje degezim i Urdherit te Kalvarit. Shoqeria Demolay eshte nje degezim i Freemasonerise qe shenjteron kujtimin e persekutimeve te bera ndaj Knights Templar dhe ne menyre te vecante te liderit te tyre Jacques deMolay. Kete gje e di mire sepse kam gene nje anetar i Shoqerise Demolay kur kam gene i ri. Gjithmone ne kam dashur shume misterin dhe ritualin. U shkeputa nga kjo Shoqeri kur familja ime u transferua ne nje zone ku nuk kishte asnje lozhe afer. Edhe sot e kesaj dite besoj se pjesmarrja ime ne Shoqerine Demolay ka gene arsyeja per perzgjedhjen time ne rradhet e Inteligjences se Sigurise se Marines.

Sipas pjestareve te komunitetit te Inteligjences, kur Rendi i Ri Boteror do jete i konsoliduar, reliket do nxirren nga vendi i fshehte dhe do bashkohen me Shtizen e Fatit dhe, sipas legjendes, do i japin sunduesit te botes nje fuqi absolute. Kjo gje mund te konfirmoje besimin qe na vjen nga shekuj te kaluar dhe qe pershkruan domethenien e ketyre relikeve nese bashkohen ne doren e nje njeriu te vetem. Kjo shpjegon dhe kerkimin e deshperuar te Hitlerit gjate Luftes se Dyte Boterore per keto relike.

Kaloresit e Tempullit jane themeluar diku nga shekulli i 11-te, ne Jeruzalem nga Te Urtet e Sionit [Priure de Sion] me qellimin e vetem per te ruajtur reliket e mbetura te Jezusit dhe per te siguruar nje mbrojtje ushtarake per udhetaret fetare gjate pilgimazhit te tyre per ne Qytetin e Shenjte.

Te Urtet e Sionit ishin nje Urdher fetar i themeluar ne Malin Sion ne Jeruzalem. Urdheri i vuri qellimin vetes qe te mbronte dhe te rregjistronte trashegimine e Jezusit dhe te Shtepise se Davidit. Duke perdorur cdo rruge dhe menyre te mundeshme Te Urtet e Sionit arriten te gjenin dhe te merrnin cdo relik te mbetur. Keto relike ju besuan per ti ruajtur Kaloresve te Tempullit. Jam i mrekulluar me autoret e librit Holy Blood, Holy Grail dhe informacionin qe ata kane zbuluar. Por me shume jam i shtangur nga paaftesia e tyre per te vene sebashku pjeset e mozaikut. Thesari i fshehur ne France nuk eshte thesari i Tempullit te Izraelit. Eshte vete Holy Grail, manteli i Jezusit, pjeset e mbetura nga Kryqi i Kryqezimit dhe, sipas informacioneve qe kam, mbeturina kockash te dikujt. Nese me kane thene te verteten, atehere realiteti i atyre kockave do trondisin boten mbare

nga themelet. Reliket jane te fshehura ne France. E di vendin se ku dhe po ashtu e dine dhe autoret e librit, por ata nuk e dine qe ne fakt e dine vendin.

Adam Weishaupt ishte nje prift jezuit dhe nje i Nisur i Illuminatit. Dega qe ai themeloi ne Gjermani ishte e njejta ajo qe diskutuam me siper. Lidhja me jezuitet eshte shume e rendesishme sic do e shikoni me vone ne kete material. Studiuesit ne pergjithesi bien dakort qe ai u financua nga Shtepia Rothschild. Weishaupt mbronte idene e zhdukjes se prones private, zhdukjen e patriotizmit, zhdukjen e te gjitha qeveria nacionale, zhdukjen e pasurise se trashëguar, zhdukjen e jetes familjare si nje qelize ku jane mbeshtetur te gjitha civilizimet si dhe zhdukja e cdo forme besimi fetar ekzistues ne menyre qe ideologjia e totalitarizmit mund te imponohet kollaj mbi njerezimin.

Ne te njejtin vit kur ai themeloi Illuminatin, Weishaupt publikoi Pasurine e Kombeve, libri i cili krijoi bazat e Kapitalizmit dhe te Revolucionit Industrial. Nuk eshte aspak rastesi qe Deklarata per Pavaresi eshte shkruar ne te njejtin vit. Ne anen e perparme te Stemes se Madhe te Shteteve te Bashkuara kush eshte i mencur se ka te veshtire te dalloje Syrin qe Sheh Cdo Gje si dhe shenja te tjera te Vellazerise se Gjarperit.

Cdo doktrine ishte e njejta. Te dhenat dhe studimet konfirmojne se Illuminati i Weishaupt ishte i njejte me Te Ndricuarit e Afganistanit dhe kulte te tjera qe e quanin veten e tyre "te ndricuar". Alumbradosit e Spanjes ishin te njejte me Guerinetet e Ndricuar te Frances. Ne Shtetet e Bashkuara ata njiheshin me emrin Klubi Jakobin. Sekrete mbi sekrete dhe vetem sekrete... por gjithmone berthama ishte Vellazeria.

Mendoj se Weishaupt u tradhetua dhe u manipulua qe te persekutohej sepse ai injoroi rregullin qe fjala Illuminati ose ekzistenca e Vellazerise nuk duhej te eskpozohet kurre ne publik. Megjithate ekspozimi qe ai beri pati nje vlere te madhe per vete Vellazerine sepse ju lejoi atyre te shperndanin lajmin qe Illuminati ekziston por qe u shkaterrua dhe nuk eshte me pjese e realitetit. Kjo i mundeson anetareve te tij qe te kundershtojne idene e konspiracise. Ne kete rast mund te jete dhe ana tjeter e medaljes qe Weishaupt nuk u tradhetua por veprroi sic u urdherua te vepronte.

Ai ka thene: "Fuqia me e madhe e Urdherit tone qendron tek fshehtesia e tij, asgje nuk ndodh ne emer te tij dhe gjithmone mbulohet nga nje emer tjeter dhe profesion tjeter."

Dyshimet se organizatat Freemasonet u infiltruan nga Illuminati gjate periudhes se Weishaupt jane mbrockulla. Freemasonet ne rrangjet e tyre te larta gjithmone kane perbere zemren e Illuminatit dhe kjo eshte arsyeja pse i moren ne mbrojtje dhe i fshehen me aq deshire pjestaret e grupit te Weishaupt. Ju nuk besoni me te vertete qe nese Freemasonet do ishin nje organizate e thjeshte vellazerore do rrezikonin aq shume te fshihnin ne gjirin e tyre anetare te nje organizate te jashteligjshme dhe te denueshme nga gjithe monarkite e Europes. Jane vete autoret Freemasonet ata qe shperndane mitin qe Adam Weishaupt ishte themeluesi i Illuminatit dhe se Illuminati u shkaterrua qe te mos rilinde me kurre.

Ne vitin 1826 nje Amerikan Freemason shkruajti nje liber qe zbulonte sekrete te Masonerise, te quajtur Ilustrime te Freemasonerise. Njeri nga sekretet qe ai nxorri ne shesh ishte qe misterit i fundit ne maje te piramides Masonike eshte Falja [adhurimi, lutja] ndaj Luciferit. Ne kemi mesuar te verteten mbi sekretin e "historise se vrasjes se Hiram Abif." Hiram Abif perfaqeson inteligjencen, lirine dhe te verteten dhe u godit me furi ne qafe nga nje vizor qe perfaqeson ndrydhjen e fjales se lire nga kisha; me pas ai u godit ne zemer nga nje katror qe perfaqeson ndrydhjen e besimit nga Shteti; dhe sefundi u godit ne koke nga nje cekic qe perfaqeson ndrydhjen e inteligjences nga masat. Ne kete menyre Freemasoneria barazon Kishen, Shtetin dhe masat me Tiranine, intolerancen dhe injorancen. Ajo qe Morgan [autori i librit] beri publike ishte Freemasonet ishin te betuar te hakmerreshin per Hiram Abif dhe se plani i tyre ishte te rrezonin Kishen , Shtetin dhe lirine e masave. Nxjerrja ne shesh e ketyre fakteve shkaktoi nje levizje te fuqishme anti-masonike. Dhe kjo levizje u kthye ne nje terhim te vertete kur u mesua se autori, William Morgan, u gjet i mbytur ne Liqenin e Ontarios. Pretendohet se kjo u be nga anetaret masonore por edhe sot e kesaj dite ata e mohojne nje fakt te tille. Betimi qe kryhet ne momentin e Nisjes percakton qarte qe nese nxirren sekretet atehere i Nisuri do vritet. Fakte te tilla bene qe levizja masonike te pesonte nje humbje te madhe anetaresie dhe duke filluar nga viti 1800 deri ne vitin 1840 rradhet e saj rane ndjeshem. Pra zgjati vetem 40 vjet dhe ne vitin 1840 partia anti-masonike u shperbe. Koha eshte ilaci me i mire apo jo?

Ne dime qe Freemasonet Britanike jane nje grup qe i sherbejne vetem vetvetes dhe qe diskriminojne ne favor te perfitimeve personale per vende pune, emerime me te mira, kontrata apo karriera. Organizatat Freemasonore angleze jane perdorur nga KGB-ja per te infiltruar dhe marre nen kontroll Inteligjencen Britanike. Inteligjenca Britanike eshte nje sinonim i Shtepise Catham, e njohur ndryshe si Instituti Mbreteror per Punet e Jashteme, organizata meme e Keshillit per Marrdheniet me Jashte ne Shtetet e Bashkuara. Policia shtetere angleze, Scotland Yard urdheroi personelin e saj qe te mos anetaresohej tek Masonet duke ju druajtur faktit qe e njejta gje do i ndodhte dhe atyre. Natyrisht qe ju keni degjuar gjithnje jeten tuaj tju thuhet se Freemasonet jane nje organizate vellazerore pozitive dhe e perkushtuar ne sherbimet shoqerore. Pra beni mire te lexoni keto qe shkruajta me siper o njerez te pafajshem.

Mbase lozha me e njohur Freemasonore eshte lozha P2 ne Itali. Ky grup ka qene i implikuar ne cdo gje, qe nga vjedhjet dhe grabitjet e rendomta deri tek vrasjet. P2 eshte e lidhur direkt me Vatikanin, Kaloresit e Maltes [Knights of Malta] dhe me Agjensine Qendore te Inteligjences [CIA] ne Amerike. Eshte shume e fuqishme dhe e rrezikshme. Lozha P2 ja ka dale mbane te infiltroje Vatikanin dhe me nje rezultat domethenes. Papa John Paul II ka hequr mallkimin ndaj Freemasonerise. Shume pjestare te rangut te larte te Vatikanit tani jane Freemasonore.

Pra mund tju them me plote gojen qe Freemasoneria eshte nje nga organizatat me djallezore dhe te temerrshme ne faqen e dheut. Masonet jane lojtaret kryesore ne luften per dominimin e botes. Grada 33 eshte ndare ne dy pjese. Njera nga pjeset permban berthamen e Illuminatit Luciferian ndersa pjesa tjeter permban ata qe nuk kane dijeni per tjetren.

Te gjithë oficeret e inteligjences per te cilet kam punuar kur isha ne Inteligjencen e Marines ishin Masone. Sic e thashe me siper, besoj se anetarisa ime ne Shoqerine DeMoley kur kam qene i ri, ka qene arsyeja qe u zgjodha si pjestar i Sigurise dhe Inteligjences se Marines. Sidoqofte ky eshte mendimi im.

Kisha nder mend te sqaroja me detaje lidhjet e P2 me te Urtet e Sionit, Vatikanin, CIA, organizaten per nje Europe te Bashkuar dhe Grupin Bilderberg. Per fat te mire, Michael Baigent, Richard Leigh dhe Henry Lincoln, ma kaluan. Them per fat te mire sepse ata konfirmuan theniet e mija qe kam publikuar me pare.

“Qeveria Sekrete” per te cilen CIA kishte planet e saj njoftoi agjentet qe kishte ne brendesi te Vatikanit. Ju duhet te lexoni Holy Blood, Holy Grail si dhe Trashegimine Mesianike, te dyja nga Baigent, Leigh dhe Lincoln. Cdo librari me reputacion duhet ti mbaje keto libra. Midis faqeve 343 dhe 361 tek Trashegimia Mesianike ju mund te lexoni per aleancen e fuqive e cila rezultoi ne krijimin e qeverise sekrete boterore.

Shume nga anetaret e Freemasonerise nuk jane ne dijeni qe Illuminati praktikon ate qe quhet “sekret perbrenda sekretit” ose “organizate perbrenda organizates” dhe kjo eshte njera nga qellimet e Nisjes. Nuk mund te shfajesoje asnje nga anetaret apo ata qe anetaresohen ne nje shoqeri pa patur idene ose pa mesuar me pare cdo gje mbi ate organizate. Kjo eshte me te vertete nje budallallek. Vetem ata qe jane ne krye dhe qe kane kaluar cdo sprove, dine se cfare fshehin Masonet dhe si rrjedhim eshte e pamundur per ata qe jane jashte ketij rrethi vicioz te mesojne me shume detaje per grupin. Clidhje ka kjo me anetaret e rinj ose ata qe jane anetare aktuale por qe nuk kane dijeni per sekrete te tilla? Asgje pervec faktit qe shtohen budallenj me bollek. Ne kundersiztim me autoret te cilet nga frika kane kerkuar ndjese ndaj Freemasoneve, une refuzoj ti shfajesoje ata nga detyrimi dhe faji. Freemasonet di kushdo tjeter jane pergjegjes per pastertine e shtepive te tyre. Banori i nje shtepie sekrete perbrenda nje shtepie sekrete e perseri perbrenda nje tjeter shtepie sekrete nuk mund ta mbaje ate paster nese nuk mund te shikoje numrin e dhomave ose ate qe ato permbajne. Shtepia e tyre eshte nje vend i ndyre qe kuterbon. Nese mua me ndodh ndonje gje, drejttoini syte nga Masonet. Besoj se ata kane vrare me pare dhe kjo do ndodhi perseri ne te ardhmen.

Qellimi i tyre eshte te sundojne boten. Doktrina e ketij grupi nuk eshte demokracia or komunizmi por nje forme e fashizmit. Doktrina eshte nje socializem totalitar. Ne kete pike sejcili duhet te hapi syte dhe te mendoje ne menyren e duhur. Illuminati nuk jane Komuniste ndersa disa Komuniste jane Illuminati. (1) Monarkia [teza] u perball me Demokracine [antiteza] ne Luften e Pare Boterore qe rezultoi me formimin e Komunizmit dhe te Lidhjes se Kombeve [sinteza]. (2) Demokracia dhe Komunizmi [teza] u perballen me Fashizmin [antiteza] ne Luften e Dyte Boterore dhe qe rezultoi ne nje organizate akoma me te fuqishme te Kombeve te Bashkuara [sinteza]. (3) Kapitalizmi [teza] tani po perballlet me Komunizmin [antiteza] dhe rezultati do jete nje Rend i Ri Boteror totalitar socialist [sinteza].

Ne vitin 1953 raporti i Komitetit Investigativ te Senatit te Kalifornise mbi Edukimin deklaroi: "I ashtuquajturi Komunizmi modern eshte mesa duket e njejta konspiraci hipokrite per te shkaterruar civilizimin qe eshte themeluar nga Illuminati dhe qe ngriti koken ne vendin tone ne momente kritike te historise perpara se te adoptohej Kushtetuta jone. " Senati i Kalifornise e kuptoi qe komunizmi eshte veper e Illuminatit. Por ata deshtuan ne te kuptuarin e faktit qe Keshilli i Mardhenieve me Jashte dhe Komisioni Trilateral jane po ashtu veper e Illuminatit. Ju DUHET te filloni te mendoni ne menyre te drejte. Armiku nuk eshte komunizmi, eshte Illuminati. Komunistet sdo jene me te lumtur se ne me Rendin e Ri Boteror.

Shpresoj tju bej te kuptoni qarte se shumica e shoqerive moderne sekrete dhe sidomos ato qe praktikojne shkalle te Nisjes dhe ky eshte celesi, jane ne te vertete shoqeri me nje qellim te vetem. Ju mund ti quani ato me cfare do emri qe deshironi; Urdheri i Kalvarit, Shoqeria Jason, Roshaniya, Qabbalah, Knights Templar, Knights of Malta, Knights of Columbus, Jezuite, Masone, Urdheri i Lashte dhe Mistik i Rosea Crucis [Rosicrucianet], Illuminati, Partia Naziste, Partia Komuniste, Anetaret Ekzekutiv te Keshillit per Mardheniet me Jashte, Grupi, Vellazeria e Dragoit, Rosicrucianet, Instituti Mbreteror i Mardhenieve Nderkombetare, Komisioni Trilateral, Grupi Bilderberg, Shoqeria Sekrete e Hapur dhe Miqesore [Vatikani], Russell Trust, Kafka dhe Kockat, Lista dhe Celesi, Urdheri, jane te gjitha te njejte dhe te gjitha punojne drejt nje qellimi te caktuar, Nje Rend i Ri Boteror.

Sidoqofte shume prej tyre nnuk bien dakort se kush ekzaktesisht do sundoje ne kete Rend Te Ri Boteror dhe kjo shkakton ate qe disa here ata veprojne ne drejtime te kunderta ndonese ne linje te pergjithshme procedojne drejt te njejtit qellim. Nje shembull konkret eshte Vatikani qe do qe Papa te drejtoje koalicionin boteror. Disa duan Lordin Maitreya qe te drejtoje Rendin e Ri Boteror. Lordi Maitreya eshte nje nga lojtaret kryesore qe del sipas deshmimeve te personave qe e kane pare ne takimin ne nje anije ne Malte me Bushin dhe Gorbacovin si dhe 10 lidere te tjere rajonal, koka te rendesishme te Rendit te Ri Boteror. "Rreth 200 personalitete nga e gjitha bota moren pjese ne nje konference te madhe te ideuar nga Maitreya ne Londer ne 21 dhe 22 prill te vitit 1990. Perfaqesues te qeverive [perfshi edhe USA], pjestare te familjeve mbreterore, lidera fetare dhe gazetare, te gjitha ata qe ishin takuar me pare me Maitreya moren pjese ne kete konference.

Dikush ka shpenzuar dhe nje sasi te madhe parashe per te deklaruar pranine e vet ne kete konference. Papa duhet te aprovoje nese Maitreya eshte i zgjedhuri ose jo por sidoqofte kjo do permbushte profecine e Bibles ne Librin e Apokalipsit qe thote se bisha e pare do i jepet fuqia nga Roma. Nese ju mund te interpretoni Biblen si une atehere ju do e shikoni qarte qe Papa do jete fituesi dhe sunduesi ne rrolin e bishes se dyte.

Ne vitin 1952 u krijua nje alenance per here te pare ne histori duke i bashkuar gjitha grupet. Familjet e Zeza, Illuminati [urdheri], Vatikani dhe Freemasonet tani punojne sebashku per te sjelle Rendin E Ri Boteror. Ata te gjitha do pretendojne qe jane te pafajshem dhe do bejne cdo gje qe kane ne dore dhe ne fuqine e tyre per te shkaterruar kedo qe guxon te thote te kunderten. Pa dyshim qe mbas botimit te ketij libri une do vihem ne shenjester prej tyre.

Ju mund te vini re ne paragrafet e sapo permendura qe ata qe jane te listuar ketu nuk jane ose duket sikur nuk jane praktikante te shkalleve te Nisjes. Kjo eshte per syte e publikut. Shikoni Keshillin e Mardhenieve me Jashte. Disa anetare ne fakt sepse pjesa me e madhe nuk sherben ne Komitetet Ekzekutive. Ata asnjehere nuk kalojne ne asnje lloj Nisje. Ata jane vete pushteti baze dhe perdoren per te fituar konsensusin e opinionit. Pjesa me e madhe nuk jane aspak anetare por ju krijohen rrethanat qe tju duket se jane ne te vertete anetare. Ne realitet ata jane duke u perdorur dhe kete gje ata ose nuk duan ose nuk arrijne ta kuptojne. Komiteti Ekzekutiv eshte nje berthame e brendeshme bashkepuntoresh intim, anetare te nje shoqerie sekrete te quajtur Urdheri i Kalvarit, e njohur ndryshe dhe si Shoqeria Jason, e perkushtuar ne nje qellim te vetem. Anetaret jane nje rreth i jashtem ku qendra vepron sipas interesave te saja, patronazhit dhe presionit shoqeror. Ne kete menyre ata bene per vete Henry Kissinger. Rockefeller i ka Kissinger nje shume prej 50 mije dollaresh ne fillim te viteve 50-te shume qe perbente nje pasuri te vertete ne ate kohe dhe e beri Henry nje anetar te Keshillit per Mardheniet me Jashte. Cdokush ne rrethin e jashtem qe nuk ndjek vijen qe duhet perjashtohet dhe kjo behet nje mesim per ata qe mbeten. A e kujtoni deshiren e madhe njerezore per te qene pjestar i te Perzgjedhurve? Ky eshte principi qe ata ndjekin.

Pushteti i vertete jane ata njerez te cilet rekrutohen pa dallim nga shoqerite sekrete te Harvardit dhe Yale e njohur ndryshe si Kafka dhe Kockat dhe Lista dhe Celesi. Te dyja shoqerite jane dege sekrete (e njohur ndryshe dhe si Vellazeria e Vdekjes) e asaj qe njihet historikisht si Illuminati. Ata jane te lidhur me organizatat meme ne Angli (grupi i Universitetit te Oksfordit dhe sidomos me Kolegjin e Te Gjithe Shpirterave) dhe Gjermani (Shoqeria Thule e quajtur po ashtu Vellazeria e Vdekjes). E mesova kete gje kur isha ne Inteligjencen e Marines. Nuk kam qene ne gjendje te kuptoja pse disa nga pjestarit e Komitetit Ekzekutiv nuk ishin te listuar tek "Adresat" e Kapitullit 322 te Shoqerise Kafka dhe Kockat deri sa lexova Njerezit e Urte nga Walter Isaacson dhe Evan Thomas. Nen ilustrimin #9 ne qender te librit ju do te gjeni foton e "Lovett me skuadren e Yale, ne te djathte siper dhe nje tjetere ne plazh: Nisja e tij tek Kafka dhe Kockat u krye ne nje baze ushtarake ajrore afer Dunkirk." Kam zbuluar se anetare te ketyre dy shoqerive ishin zgjedhur nen nje praktike rutine e bazuar ne meritat e mbas kolegjit dhe nuk ishte kufizuar vetem te studentat e Harvardit apo Yale.

Vetem anetare te Urdherit bejne Nisje ne Urdherin e Kalvarit, shoqeria Jason qe perben anetaret ekzekutiv te Keshillit per Mardheniet me Jashte si dhe vete Komisionin Trilateral. Anetaret ekzekutive te Keshillit per Mardheniet me Jashte jane te zgjedhurit e vertete ne kete vend. George Bush eshte nje anetar i Urdherit. U habitet? Nuk keni pse. Babi i tij ishte po ashtu anetar dhe qe ndihmoi ne financimet ndaj Hitlerit.

Eshte e rendesishme te dini qe anetaret e Urdherit kryejne nje betim i cili i detyron ata te jene jashte cdo aleance me cdo komb, mbret apo qeveri ose kushtetute dhe kjo perfshin edhe mohimin e cdo betimi qe mund tju jete kerkuar te bejne me pare. Ata betohen per besnikeri ndaj Urdherit dhe qellimit te tij, Rendi i Ri Boteror. George Bush nuk eshte nje qytetar besnik ndaj Shteteve te Bashkuara por eshte besnik vetem ndaj shkaterrimit te USA dhe themelimit te Rendit Te Ri Boteror. Sipas betimit qe kreu Bushi kur u Nis ne Kafka dhe Kockat, betimi qe beri kur mori postin e presidentit nuk ka asnje vlere.

Komisioni Trilateral eshte nje grup elitar, perfaqesues te rreth 300 bizneseve, politikane dhe intelektuale vendim marres nga Europa Perendimore, Amerika e Veriut dhe Japonia. Kjo nderrmarje eshte nje agjensi private qe punon per te ndertuar nje bashkepunim politik dhe ekonomik midis tre rajoneve. Projekti i tyre i madh te cilin nuk e fshehin me eshte vetem nje, Rendi i Ri Boteror.

Komisioni Trilateral ishte ideja e themeluesit te tij, manjatit bankar amerikan David Rockefeller. Arsyeja e vertete per formimin e tij ishte mohimi i pushtetit te Keshillit per Mardheniet me Jashte si rezultat i pakenaqesise se popullsise ndaj Luftes ne Vietnam. Arsyeja e vertete per te kaluar ne Komisionin Trilateral ishte e njejte sikur te fusje ne gare dy kuaj. Dyfishon shanset e fitores. Pushteti i vertete ka mbetur ne doren e Keshillit per Mardheniet me Jashte. Familja Rockefeller ka qene dhe do jete gjithmone mireberesi i te dyja organizatave. Rockefeller ndonese eshte i pushtetshem, nuk eshte ne kontroll as ne kete vend dhe as ne vende te tjera. Celeri i pushtetit te VERTETE eshte fakti qe Rockefeller futi agjentet e tij ne nje mbledhje te Grupit Bilderberg ne vitin 1972 ku hodhi idene per krijimin e nje grupi privat me lidera trepalesh [trilateral]. Grupi Bilderberg u lekunden para idese dhe njeriu i Rockefeller Zbigniew Brzezinski mblodhi firmat per anetaresine dhe organizoi Komisionin Trilateral ne vitin 1972 dhe jo ne vitin 1973 sic deklaroi vete Komisioni.

Nje pike kyce i rrezikut qe paraqet Komisioni Trilateral eshte “Paqja Themelore” e shkruar per ta nga Profesori i Harvardit Samuel P. Huntington ne mes te viteve 70-te. Ne leter, profesori Huntington rekomandon se demokracia dhe zhvillimi ekonomik duhet te zhvlefteohen sepse jane ide te vjetra. Ai shkruajti ne bashke autoresi, librin Krizat e Demokracise; “Ne kemi arritur ne perfundimin se rritja ekonomike ka kufij te deshirueshem dhe po ashti edhe zgjerimi i demokracise politike. Nje qeveri te ciles i mungon autoriteti, ka pak aftesi per te impnuar mbi njerezit sakrifica qe jane te domosdoshme ne raste krizash kataklizmike. “

...Kujtohuni qe George Bush ka qene anetare i Komisionit Trilateral dhe dha doreheqjen vetem qe te behej i pershtatshem per postin e presidentit. Ai beson me shpirt ne idete dhe idealet e Komisionit. Ne kemi zgjedhur nje president qe beson se demokracia dhe zhvillimi ekonomik duhen zhvlefteuar. Mund tju them me plote gojen se ai tani eshte duke punuar drejt ketij qellimi. Bush vazhdon te jete nje anetar i Urdherit dhe i Keshillit.

Shoqeria JASON ose shkenctaret e Jasonit e ka marre emrin e saj nga legjenda e Jasonit dhe Lekures se Arte (**Kujtoni Legjenden e Argonauteve –Darius**) dhe eshte nje dege e Urdherit te Kalvarit nje nga shkallet me te larta te Illuminatit. Lekura e Arte per anetaret e Jasonit merr kuptimin e te vertetes. Jasoni perfaqeson kerkimin e te vertetes. Megjithate emri JASON shkruhet me germa te medhaja kur flitet per Shoqerine Jason. Vete emri Jason si dhe Lekura e Arte mund te kene nje kuptim akoma dhe me te fshehte pasi e hasim shpesh gjate rrjedhes se historise neper shoqeri te ndryshme sekrete.

Sipas dokumentave sekrete qe kam lexuar thuhet se Presidenti Eisenhower kishte ngarkuar Shoqerine JASON per te ekzaminuar te gjithë te dhenat, faktet, genjeshtrat dhe mashtrimet per te gjetur te verteten mbi ceshtjen aliene.

Themeluesit e Grupit JASON (Jo te njejte me Shoqerine JASON) perfshin anetare te te famshmit Projekti Manhatan qe bashkoi pothuajse te gjithë fizikantet me ne ze te vendit per te ndertuar bomben atomike gjate Luftes se Dyte Boterore. Grupi ishte i perbere ne shumicen e tij nga fizikiantë teoricienë dhe qe ishte pjesa me elitare e komunitetit shkencor te Shteteve te Bashkuara. Deri ne vitin 1987, anetaresia perfshinte kater fitues te cmimit Nobel. Sot JASON vazhdojn ti ofroje nj ndihme shkencore qeverise qe ska ku e gjen ne vend tjetër. Ata mbase jane i vetmi grup shkencor qe njeh me hollesi gjendjen e vertete te zhvillimit teknologjik te Amerikes.

JASON eshte i ndrydhur nga ajo qe duket si nje fshehtesi e kote. Grupi refuzon te nxjerre emrat e anetareve te tij. Asnje nga anetaret nuk perfshin emrin e JASON ne kurrikulumin e tyre. Duke punuar teresisht mbrapa skenes, JASON ka drejtuar vendim me te rendesishme per sigurine kombetare. Kjo perfshin, por qe nuk eshte e kufizuar vetem ketu, Luften e Yjeve, luften me nendetese si dhe parashiket per efektin e seres [green house]. Anetaret e JASON paguhen 500 \$ ne dite per rrolin e tyre si keshilltare. Sipas dokumentave qe kam lexuar JASON kane parashikuar qe efekti sere do e coje planetin ne menyre te padiskutuar ne nje Epoke Akullnajash.

Sipas Pentagonit, JASON zene vendet me te larta dhe me akses sigurie me te madhe ne vend. Ata kane pozicionin protokollar te nje Admirali [rezerve] me dy yje ne rastet kur vizitojne ose udhetojne neper anijet per ne bazat ushtarake. E vetmja reference qe kam gene ne gjendje te zbuloj eshte ajo e Letrave te Pentagonit. Ne to thuhet se JASON ishin pergjegjes per disenjimin e barrieres elektronike midis Veriut dhe Jugut te Vietnamit me qellimin per te bllokuar hyrjen e veriut Vietkongeve ne Jug gjate luftes se Vietnamit. Kam gene vete ne nje nga vendet ku ishte instaluar kjo mbrojtje dhe mund tju deklaroj qe nuk punonte.

Vello e sekretetit qe eshte hedhur mbi Grupin JASON eshte kaq e dendur dhe kaq e puthitur qe nga krijimi i tij saqe kur ndonje nga ata qe punon aty mendon se qeveria nuk eshte ne gjendje te ruaje sekretin atehere ata vendosin te rishikojne pozicionin e vete qeverise. Vete qeveria ka gene ne gjendje te mbroje sekretin e JASON, pervec nje rasti ndersa kur bie fjala per vete Grupin JASON, nje grup civil, asnjehere nuk ka dale fjala me e vogel prej tyre. JASON eshte e administruar nga Mitre Corporation. Kontratit qeveritare qe i jepen Mitre Corporation ne fakt i jepen vete shkenctareve te JASONIT. Kjo eshte bere per arsyen qe emri i JASONIT mos shfaqet kurre neper dokumenta dhe te terheqi ne kete menyre vemendjen e publikut.

Kush eshte diferenca midis Shkenctareve te JASONIT apo Shoqerise JASON dhe Grupit te JASONIT? Dokumentat qe kam lexuar i referohen shoqerise JASON saktesisht me keto fjale. Ne dokumentat publike e vetmja reference per JASON eshte ajo e Grupit JASON i administruar nga Mitre Corporation. Besoj se Shoqeria JASON eshte nje nga shkallet me te larta mbi Kafka dhe Kockat dhe Letra dhe Celesi ne Illuminati. Me fjale te

